



GILOGOC MUNICIPALITY			
Priredit	08.01.2019		
IN/ Org.	Numër	Shtojca	Viera
01	060	1183	

**REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA DRENAS**



**PLANI VJETOR I KRYETARIT TË
KOMUNËS DHE QEVERISË
KOMUNALE**



**DRENAS
2019**

PËRMBAJTJA

1. HYRJE.....	3
2. PARIMET E QEVERISJES SË KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE	3
3. PRIORITETET E PËRCAKTUARA NË FILLIM TË MANDATIT	3
4. PLANIFIKIMET SIPAS DREJTORIVE	4
4.1. Administrata dhe Personeli	4
4.2. Buxhet dhe financa	4
4.3. Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia	4
4.4. Infrastruktura Publike	5
4.5. Kadastra dhe Gjeodezia	7
4.6. Planifikimi Urban dhe Mjedis	7
4.7. Shëndetësia dhe mirëqenia sociale	7
4.8. Kulturë, Rini, Sport	7
4.9. Arsim dhe Shkencë	7
4.10. Inspekcioni	8
4.11. Bujqësia	9
4.12. Zhvillimi ekonomik	9

1. HYRJE

Plani i punës për vitin 2019 përmban prioritetet e Kryetarit të Komunës, Ramiz Lladrovci dhe politikat e qeverisjes komunale. Përmes këtij plani synohet të zhvillohet plani i veprimit brenda Komunës me qëllim të realizimit të objektivave të planifikuara.

Ky dokument paraqet prioritet njëvjeçare të Kryetarit dhe të qeverisjes komunale. Qëllimi i tij është që në vija të trasha të orientojë punën e Kryetarit dhe qeverisjes komunale për plotësimin dhe realizimin e kërkesave të qytetarëve në bazë të planifikimit të buxhetit përmes përdorimit të tij në mënyrë të përgjegjshme dhe me transparencë, llogaridhënie, parime këto thelbësore për qeverisje të mirë.

Pjesë përbërëse e planit të punës se ekzekutivit komunal për vitin 2019 janë edhe planet e punës e të gjitha drejtive dhe njësive komunale.

2. PARIMET E QEVERISJES SË KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE

Unë garantoj se llogaridhënia dhe transparenca do të jenë shtyllat e punës sime. Unë garantoj se çdo vendim në Komunën e Drenasit do të jetë i hapur për qytetarë dhe për pjesëtarët e shoqërisë civile.

Ligji i aprovuar nuk negociohet, vetëm zbatohet.
(Ramiz Lladrovci)

Kryetari i Komunës dhe drejtoret e drejtive zotohen se gjatë qeverisjes se tyre do t'i ndjekin parimet e qeverisjes se mirë si: Sundimi i ligjit, përgjegjësia, besueshmëria dhe parashikueshmëria, qeverisja e hapur, transparenca, llogaridhënia, efektiviteti, bashkëpunimi (partneriteti), koheranca, efikasiteti (produktiviteti).

Kryetari i Komunës e ka bërë të qartë që nga fillimi i mandatit se do t'i përbahet sundimit të ligjit duke kerkuar përgjegjësi nga të gjithë vendimmarrësit për veprimet e tyre nëse bien ndesh me sundimin e ligjit dhe për çdo keqadministrim të parasë publike. Ky realizohet edhe duke ofruar qasje të plotë për të gjithë të interesuarit në dokumentacionin administrativ. Ky proces u ofron të gjithë qytetarëve të Komunës së Drenasit mundësi jo vetëm që të informohen por edhe të kontribuojnë në të mirën publike dhe interesin e përgjithshëm duke kerkuar informacione dhe duke i denoncuar ato raste ku ata mendojnë se mund të ketë veprime në kundërshtim me ligjin. Kryetari do të vazhdojë të respektojë ligjin duke pezulluar të gjithë zyrtarët të cilëve u ngritë aktakuze. Prioritet vazhdon të mbetet edhe përfaqësimi i gjinor në funksion të një demokracie të mirëfilltë.

Kryetari i Komunës mirëpret angazhimin dhe kontributin e qytetarëve të Komunës dhe organizatave të ndryshme të cilat kanë për qëllim të mire përmirësimin e jetës së të gjithë qytetarëve të Komunës përmes një ekzekutiv funksional dhe të përgjegjshëm.

3. PRIORITETET E PËRCAKTUARA NË FILLIM TË MANDATIT

Buxheti i Komunës së Drenasit do të jetë një buxhet i qytetarëve. Ky buxhet do të bëhet duke shkuar lagje për lagje dhe duke marrë rekomandimet dhe nevojat e qytetarëve.

Hartimi i Buxhetit bashkë me qytetarët dhe që investimet të jenë të prekshme për të gjithë qytetarët e Komunës sonë.

I gjithë procesi i prokurimit publik të jetë i hapur për monitorim nga pjesëtarët e shoqërisë civile dhe të gjithë ata që janë të interesuar ta monitorojnë këtë proces, do të jenë të mirëseardhur.

Kontratat qe të lidhen me çdo kompani, të publikohen në ueb faqe të Komunës, së bashku me përshkrimin e punës, me qëllim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënieς.

Planet rregullative të bëhen me pjesëmarrjen e qytetarëve në lokalitetet ku jetojnë. Planet rregullative të jenë në harmoni me nevojat e qytetarëve për një jetë kualitative.

Parandalimi i usurpimit të pronës publike dhe përpjekje që prona e publike e usurpuar t'i kthehet Komunës.

Punësimi në institucionet e Komunës do të bëhet me mbikëqyrjen e Organizatave Joqeveritare, në mënyrë që punësimi të bëhet me merita dhe me kualifikimin e duhur.

4. PLANIFIKIMET SIPAS DREJTORIVE

4.1. Administrata dhe Personeli

Përmirësimi dhe digjitalizimi i shërbimeve dhe proceseve të punës për shërbime më të mira për qytetarët e Komunës;

Furnizimi me inventar, me kompjuterë dhe pajisje tjera të nevojshme për punë më efikase;

Mirëmbajta dhe renovimi i zyrave të gjendjes civile;

4.2. Buxhet dhe financa

Hartimi i rregulloreve komunale për çështjet financiare;

Ndihmese në përgatitjen e projekt –buxhetit dhe mbajtja e llogarive dhe raporteve financiare vjetore;

Menaxhimi i thesarit nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Komunës;

Mbikëqyrja dhe monitorimin e sistemeve dhe procedurave për ekzekutimin e buxhetit.

Përgatitja e procedurave dhe raporteve të kontabilitetit;

Gatishmërisa për të ofruar këshilla profesionale nga fusha e buxhetit për organet tjera komunale;

Përlllogaritja dhe caktimi i tatimit në pronë, taksat komunale dhe ngarkesat tjera;

Punë tjera të caktuara nga Kryetari i Komunës.

4.3. Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia

Rregullimi dhe rrethimi i varrezave në Komunën e Drenasit;

Renovimi dhe mirëmbajtja e objektit të SHZSH-së në Gllobar;

Zgjerimi dhe mirëmbajtje e kamerave në Komunë;

Instalimi i ndriçimit të ri dhe riparimi i rrjetit të ndriçimit publik ekzistues;

Rregullimi dhe kultivimi i sipërfaqeve gjelbëruese dhe rregullimi sheshit të Drenasit;

Rregullimi dhe mirëmbajtja e trotuareve dhe parkingjeve;

Reabilitimi i rrugëve të asfaltuar në Komunën e Drenasit;

Rregullimi dhe mirëmbajtja e tregjeve;

Sinjalizimi vertikal dhe horizontal i rrugëve dhe vendbanimeve;

Mirëmbajtja e kanalizimeve fekale atmosferike dhe gropat septike;

Bashkëfinancime të ndryshme projektesh;

Riparimi dhe zgjerimi i vendndaljeve për autobus dhe mbulimi tyre.

4.4. Infrastruktura Publike

Ndërtimi i infrastrukturës(Asfaltimi dhe kubzim)Drenas I, II, III dhe IV;

Ndërtimi i kapacitetit të ujësjellësit në Drenas;

Kanalizimi i Ujërave të zeza në fshatin Llapushnik, Potërk dhe Vukovc;

Reabilitimi i dhe Rikonstruktimi i rrjetit të kanalizimeve në Komunën e Drenasit;

Asfaltimi i rrugës në fshatin Sankoc, Fushticë e Epërme dhe Ulet;

Kanalizimi ujërave të zeza Korroticë e Ulet ,Epërme Poklek i Ri dhe Vjetër;

Asfaltimi i rrugës në fshatin Dobroshec, Çikatovë e Vjetër;

Kanalizimi i ujërave të zeza dhe atmosferike Drenasin I, II, III dhe IV;

Zgjerimi dhe ndërtimi i sheshit "Fehmi e Xhevë Lladrovci" Drenas;

Infrastruktura në Komoran I,II,III dhe IV;

Bashkëfinancim projekte me donatorë të jashtëm;

Kanalizimi i ujërave të zeza në fshatin Nekoc, Kishnarekë;

Asfaltimi i rrugës në fshatin Tërdec-Vuçak;

Kanalizimi i ujërave të zeza Dobroshec Çikatovë e Vjetër;

Hartimi i projektit të fizibilitetit për ngrohjen qendrore;

Asfaltimi i rrugës në fshatin Baicë, Krajkovë, Damanek;

Kanalizimi i ujërave të zeza Komoran I, II, III dhe IV;

Kanalizimi ujërave të zeza Baicë, Krajkovë, Damanek dhe Shtrubullovi;

Asfaltimi i rrugës në fshatin Gllanasellë, Godanc;

Mbikëqyrja e projekteve kapitale në KK Drenas;

Kanalizimi i Ujërave të zeza në fshatin Shtuticë, Vërboc;

Rregullimi i shtratit të lumit Drenica dhe Vërbica;

Asfaltimi i rrugës Shtuticë, Vërboc dhe Polluzhë;

Kanalizimi ujërave të zeza në fshatin Abri Epërme, Tërdec;

Ndërtimi Infrastrukturës në fshatin Nekoc ,Kishnarekë;

Kanalizimi i ujërave të zeza Arllat, Negrovci dhe Gjergjicë;

Asfaltimi rrugës Llapushnik Berishë;

Asfaltimi i rrugës Tërstenik I dhe II;

Hartimi i projekteve zbatuese për nevojat e Komunës;

Ndërtimi i kolektorëve për grumbullimin e ujërave të zeza në Komunë;

Asfaltimi i rrugës fshatin Llapushnik Poterk-Vukovic;

Kanalizimi i ujërave të zeza në fshatin Gllanasellë dhe Godanc;

Ndërtimi i urave Tombinave dhe mureve mbrojtëse;

Asfaltimi i rrugës në fshatin Gradicë dhe Likoshan;

Kanalizimi i ujërave të zeza Sankoc Fushticë e Epërme dhe e Ulet;

Rregullimi i deponive mbeturinave inerte;

Asfaltimi i rrugës në fshatin Poklek i Vjetër, Poklek i Ri, Vasilevë;

Rregullimi i Vend-ndaljeve dhe mbulimi i tyre;

Rregullimi i infrastrukturës trotuar dhe ndriçim Publik Komunën e Drenasit;

Asfaltim në fshatin Zabel i Ulet dhe Epërm, Korroticë e Ulët dhe Epërme;

Kanalizimi i ujërave të zeza në fshatin Gradicë, Likoshan;

Reabilitimi dhe Rikonstruimi i rrugëve të asfaltuar në Drenas;

Asfaltimi i rrugës në fshatin Arllat, Negroc, Gjergjicë si dhe Bytyq;

Kanalizimi i ujërave të zeza Tërstenik I dhe II;

Infrastrukturë në fshatin Abri e Epërme, Tërdevc;

Hapja e Kanaleve kulluese për gjate rrugëve në Komunë.

4.5. Kadastra dhe Gjeodezia

Furnizimi me pajisje të nevojshme për kryerje efikase të punëve;

Kryerja e procedurave të nevojshme për shpronësim;

Përgjigje në kërkesat e qytetarëve për çështje të matjes se pronave dhe pronësisë së pronave brenda afateve të parapara.

4.6. Planifikimi Urban dhe Mjedisi

Hartimi i planeve rregulluese të hollësishme;

Mirëmbajtja e sistemit të adresave vendosja e tabelave dhe numrave në teren;

Gjelbërimi i hapësirave publike.

4.7. Shëndetësia dhe mirëqenia sociale

Instalimi i ngrohjes dhe ndriçimit solar në QKMF;

Zgjerimi i ambulancës në fshatin Tërstenik;

Renovimi i QMF Gllanasellë;

Renovimi i QMF në Abri;

Pajisje speciale mjekësore mbi 1000 euro;

Ndërtimi QMF-se Baicë;

Autoambulanca.

4.8. Kulturë, Rini, Sport

Ndërtimi i stadiumit faza e dytë;

Renovimi i objektit të arkivit Komunal;

Renovimi i objekteve sportive;

Ndërtimi i poligonit sportiv në Tërstenik, fushave sportive dhe rekreative.

4.9. Arsim dhe Shkencë

Renovimi i nyjeve sanitare të shkollave;

Ndërtimi anekseve shkollore;

Furnizimi i shkollave me kabinet për kimi dhe fizikë dhe biologji;

Inventarizimi i shkollave në Drenas;

Rrethoja e oborreve të shkollave;

Renovimi i objekteve shkollore (kulm, dysheme dhe ndërrimi i dyerve dhe dritareve);

Ndërtimi, rrithimi i fushave sportive;

Riparimi i ngrohjeve qendrore(radiatore dhe pajisje tjera përcjellëse);

Ngjyrosja dhe suvatimi i objekteve shkollore;

Termoizolimi i objekteve shkollore;

Ndërtimi i depove për lendi djegëse neper shkolla;

Ndërtimi i platove për rreshtimin e nxënësve dhe trotuareve me kubeza;

Furnizimi i shkollave me pajisje të TIK-ut.

4.10. Inspekcioni

Inspektime të ndërtimeve të objekteve të ndërtimit kolektiv, privatë, objekteve afariste, rrugëve dhe kanalizimeve të ujërave fekale;

Inspektime në fushën sanitare në mbështetje të Ligjit përkatës;

Inspektime nga fusha e veterinës në mbështetje të Ligjit përkatës;

Inspektime në fushën e mbrojtjes së ambientit në mbështetje të Ligjit përkatës;

Inspektime të veprimtarive ekonomike dhe bizneseve të ndryshme në Komunë duke kontrolluar të gjitha bizneset e regjistruara dhe ato të cilat janë të pa regjistruara dhe ndërmerr veprimet përkatëse ligjore;

Inspektime financiare, inspektimin e tregut dhe çmimeve në pajtim me Ligjin përkatës;

Inspektime nga lëmi i bujqësisë në pajtim me Ligjin përkatës;

Inspektime të shërbimeve komunale, rrugëve shesheve, parqet, varrezat, përcjellja e trafikut të auto takstive, kombi takstive, autobusëve dhe automjeteve për transport, reklamat e ndryshme të bizneseve dhe të tjera;

Inspektime për parandalim dhe mbrojtje nga zjarri si dhe fatkeqësitetë tjera elementare;

Inspektime të kushteve të punës bazuar në Ligjin për Inspektimin ndaj punëdhënësit apo përfaqësuesit të tij dhe ndaj punëtorëve.

4.11. Bujqësia

Implementimi i politikav zhvillimore në sektoret e bujqësisë;

Koordinimi dhe mbikëqyrja e asociacionev bujqësore;

Përgatija e planeve përmjet mbjelljet pranverore, vjeshtore dhe fushaten përmjet korrje-shirje;

Organizimi i trajnimeve dhe këshillimeve përmjet fermerët;

Dhënia e pëlgjimeve përmjet rikultivimin e tokave Bujqësore dhe mbajtja e evidencës përmjet tokat Bujqësore;

Bashkëpunim dhe përkrahje të aktiviteteve rreth ujitjes në Kompaninë e "Iber Lepencit" ;

Mbrojtja e resurseve natyrore duke përfshirë pyjet, reren (zhavorin) dhe aktivitetet tjera rreth gurëthyesve;

Koordinimin i punëve dhe bashkëveprimi me OJQ-të që përkrahin aktivitetet bujqësore;

Bashkëpunimi me agjencionet qeveritare përmjet zhvillimin e rajoneve rurale;

Planifikoi i zhvillimit dhe kujdesit permanent të shfrytëzimit të tokës bujqësore përmjet nevojat dhe interesat e Komunës;

Bashkëpunimi dhe koordinimi me ministrinë e bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural;

Mbrojtja e pyjeve, pyllëzimi dhe ripyllëzimi dhe planifikimi i zhvillimit rural;

Hulumton resurset natyrore duke përfshirë edhe mbrojtjen e shtazëve dhe bimëve.

4.12. Zhvillimi ekonomik

Në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës dhe Institucionet tjera Komunale, do të krijojë një kornizë të përshtatshme përmjet zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror;

Hartimin e strategjisë zhvillimore lokale në përputhje me strategjinë regionale dhe atë qendrore;

Hartimin e politikave zhvillimore dhe marrjen e masave të përshtatshme përmjet nxitje më tutje zhvillimin ekonomik -Hartimin e planeve dhe nxitjen e investimeve të jashtme;

Hulumtimin e mundësive përmjet siguruar donacione dhe burime të tjera financiare;

Ofrimin e trajnimeve dhe dhënien e këshillave përmjet bizneset e reja por edhe ato ekzistuese;

Ofrimin e shërbimeve përmjet regjistrimin e bizneseve;

Bashkëpunim dhe koordinim i projekteve lidhur me Partneritetin Publiko Privat;

Bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, MIN, MTI, MZHR dhe resorëve tjera të Qeverisë së Republikës së Kosovës;

PLANI VJETOR I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE QEVERISË KOMUNALE

Në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës bashkëpunon me Institucionet Ndërkombëtare dhe organizatat të ndryshme financiare për projekte të ndryshme zhvillimore -Organizimin e panaireve për promovimin e produkteve dhe shërbimeve të bizneseve;

Komunikimin e vazhdueshëm me diasporën për të informuar më mundësit e investimeve të mundshme;

Promovimin e turizmit në aspektin ekonomik lokal, -Fuqizimin e bashkëpunimit dhe komunikimin me Diasporën dhe promovimin e bizneseve nga Diaspora dhe mundësit e investimeve në Komunë për bizneset e Diasporës.

